

Vendim nr. 146 datë 05.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 05.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (P) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES:

PËRPARIM BOJA

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimeve nr. 96, datë 19.09.2014 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Mat; nr. 00-2016-820 (106), datë 18.05.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 1769, datë 21.12.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-1741, datë 22.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Mat dhe urdhërimi i aplikimit të gjykimit të shkurtuar për masën e dënimit të kërkesit ose ndryshimin e vendimit nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE:

Nenet 29, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të të tre të pandehurve, një prej të cilëve ishte kërkuesi Përparim Boja, duke i akuzuar për veprën penale “Vrasja me paramendim”, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 78, paragrafi 2 dhe 25 të Kodit Penal (KP).

2. Në seancën gjyqësore, në fazën e kërkesave paraprake, kërkuesi ka kërkuar pavlefshmërinë e dy akteve të hetimit paraprak – procesverbale të deklarimeve të të bashkëpandehurit, kërkesë e cila është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat. Pas kësaj, kërkuesi ka paraqitur verbalisht edhe dy kërkesa procedurale, duke kërkuar: (i) veçimin e çështjes së tij nga ajo e të pandehurve të tjerë; (ii) dhe përjashtimin e trupit gjykues. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka rrëzuar kërkesën për veçimin e çështjes, me arsyetimin se nuk verifikohej asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 93 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për gjykimin e shkurtuar të çështjes bazuar në nenet 403 e vijues të KPP-së. Edhe kjo kërkesë është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me arsyetimin se kërkuesi ka bërë dy kërkesa që përjashtojnë njëra-tjetrën (për pavlefshmërinë e akteve dhe gjykimin e shkurtuar) dhe se bazuar në nenin 404 të KPP-së, çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet (*shih faqen 3 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat*).

3. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. 96, datë 19.09.2014, ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale në ngarkim të të pandehurve, duke vendosur, ndër të tjera, deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Vrasja me paramendim”, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 78, paragrafi 1 dhe 25 të KP-së dhe dënimin e tij me 25 vjet burgim. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur apel të gjitha palët ndërgjyqëse, përfshirë edhe kërkuesin. Ky i fundit, ndër të tjera, ka kundërshtuar edhe refuzimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar të çështjes.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2097, datë 04.12.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe kthimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Gjykata e apelit ka arsyetuar se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi gjatë seancës paraprake për përjashtimin e trupit gjykues nuk rezultonte të ishte shqyrtuar nga asnjë trup gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe ky fakt përbënte shkelje të rëndë

procedurale. Ndërsa lidhur me refuzimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar të çështjes, gjykata e apelit nuk është shprehur.

5. Mbi bazën e rekursit të prokurorit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (*Gjykata e Lartë*), me vendimin nr. 00-2016-820 (106), datë 18.05.2016, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë kishte vepruar në përputhje me ligjin, pasi kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve nuk ishte paraqitur me shkrim, në format dhe në afatet e përcaktuara nga ligji. Edhe Gjykata e Lartë nuk është shprehur për refuzimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, pas rishqyrtimit të çështjes, me vendimin nr. 1769, datë 21.12.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. 96, datë 19.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, duke vlerësuar, ndër të tjera, se vendimi për rrëzimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar ishte i bazuar në ligj. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs prokurori dhe të pandehurit, midis të cilëve edhe kërkuesi.

7. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1741, datë 22.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura, përfshirë atë të kërkuesit, duke arsyetuar se ato nuk përmbanin asnjë prej shkaqeve ligjore të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se Gjykata e Apelit Tiranë i ka dhënë përgjigje të argumentuar kërkuesit lidhur me pretendimet për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar.

8. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili është regjistruar në datën 02.05.2023.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat e ka rrëzuar padrejtësisht dhe pa bazë ligjore kërkesën për gjykim të shkurtuar.

9.2. *E drejta e mosdënimit pa ligj*, e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës dhe neni 7 i KEDNJ-së, për shkak të mohimit të së drejtës për gjykim të shkurtuar të çështjes, nga i cili kërkuesi do të përfitonte uljen e dënimit me 1/3-n.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

12. Në këndvështrim të verifikimit të plotësimi të këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës. Ai është dënua penalisht me 25 vjet burgim nga procesi gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive. Kjo nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve sipas objektit, pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit, duke parashtruar përpara tyre formalisht pretendimet e paraqitura në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, kërkuuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

15. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 18.04.2023 (data e shërbimit postar),

ndërsa vendimi gjyqësor më i fundit që kundërshtohet prej tij është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 22.12.2022. Për pasojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

16. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, për shkak të rrëzimit padrejtësisht dhe pa bazë ligjore të kërkesës për gjykimin e shkurtuar. Sipas tij, arsytimi i gjykatave se kërkesa për pavlefshmërinë e akteve dhe ajo për t’u gjykuar me gjykim të shkurtuar përjashtojnë njëra-tjetrën, është në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Po kështu, kërkuuesi ka pretenduar se mohimi i së drejtës për gjykim të shkurtuar të çështjes i ka hequr mundësinë të përfitonte uljen e dënimit me 1/3-n, ndaj për këtë shkak i është cenuar edhe e drejta e mosdënimit pa ligj, që i garantohet nga neni 29 i Kushtetutës dhe neni 7 i KEDNJ-së, në kuptimin e caktimit të një dënimi penal më të rëndë se sa ai i parashikuar nga ligji.

17. Kolegji, duke mbajtur në konsideratë argumentet e kërkuessit, vlerëson t’i analizojë pretendimet e tij në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat kushtetuese, ku përfshihet edhe mosdënimi pas ligj, nuk mund të cenohen pa proces të rregullt ligjor.

18. Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Kolegji rithekson se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa i takon kërkesës për gjykim të shkurtuar, pranimi i saj është në diskrecion të gjykatës së zakonshme dhe bazohet në bindjen e brendshme të saj se çështja penale mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit dhe në rast se ai ka dyshime për këtë vlerësim, kjo mjafton që të rrëzojë

kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme, duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr.14, datë 26.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka arsyetuar në vendimin e saj për shkaqet e mospranimit të kërkesës për gjykimin e shkurtuar të paraqitur nga kërkuesi. Konkretisht, ajo ka arsyetuar se, bazuar në nenin 404 të KPP-së (në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes), çështja nuk mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, pasi fillimisht kërkuesi i kishte kundërshtuar aktet dhe se kërkesa duhet të ishte paraqitur në fillim të shqyrtimit gjyqësor dhe jo pas rrëzimit të kërkesës për pavlefshmëri aktesh (*shih faqen 3 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat*). Po kështu, ajo gjykatë ka arsyetuar se përse ka arritur në përfundimin që kërkuesi është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe ka analizuar provat ku ka mbështetur qëndrimin e saj, duke përfshirë deklaratimet e të pandehurve, harmonizuar edhe me provat e dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët gjatë gjykimit (*shih faqen 13 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat*). Pretendimi i kërkuesit për mospranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Tiranë gjatë rigjyimit të çështjes, e cila e ka gjetur të drejtë e të mbështetur në ligj vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat (*shih faqen 12-13 të vendimit nr. 1769, datë 21.12.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë*). Ndërsa, Gjykata e Lartë, në vendimin nr. 00-2022-1741, datë 22.12.2022, ka arsyetuar se gjykata e apelit në rigjykim i ka dhënë përgjigje të argumentuar kërkuesit lidhur me pretendimet për mosaplikimin në rastin konkret të gjykimit të shkurtuar (*neni 403 e vijues i KPP-së*), pretendim ky i ngritur edhe në rekurs (*shih faqen 25 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

22. Në përputhje me standardet e evidentuara në jurisprudencën kushtetuese, Kolegji vlerëson se interpretimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrëzimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar të çështjes nuk rezulton të ketë qenë i paarsyeshëm, në atë masë që të ketë cenuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor në lidhje me të drejtën e mosdënimit pa ligj, ndaj pretendimet e kërkuesit janë haptazi të pabazuara.

23. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.